

## PROJECTS FOR EUROPE-THEN AND THE REALITY OF EUROPE TODAY

Gjergj Sinani\*

### Abstract

European Integration remains, still, the most important objective of the Balkan countries. The reason is simple: To join a family in which the rule of law and democracy are the main principles of every-day life of an integrated community.

Referring to the title of this paper “Projects for the Europe,” the main question raised in this paper is: When did these “Projects for the Europe” firstly started?

In this paper I will attempt to present that the “Projects for the Europe” have started since the XVII and XVIII century, and the philosopher’s ideas of that time, especially those of French cosmopolite philosophers, are of great importance and have played a crucial role in that process. Furthermore, I will try to explain, how those ideas, with regard to the “Projects for the Europe,” were implemented in the post WW II Europe? Even though, the general idea is the European Integration; we have to take into consideration that Europe is not just a result of modern economic and political cooperation, but, first of all, it is an ideal elaborated by the great European philosophers. Rethinking the idea of Europe, even though utopic at its beginning, will help us understand the institutions of today’s Europe.

Finally, in this paper I conclude that today’s Europe is the result of continuous process of political thought, concrete and practical action. Therefore, it is necessary to avoid misunderstandings or perceptions about Europe. On the one hand, Europe, it is not a cash drawer, or even just an area of free movement of goods and people. Europe, in the first place is a space of civil liberty, solidarity and responsibility.

The core principal of political thought and practical action for Europe is the idea of peace and security. As a consequence, the source for achieving freedom, democracy and the rule of law, the idea that constitutes the pride of Europe.

**Keywords:** Projects for the Europe, Rule of law, Democracy, Ideas, Institutions.

---

\*Prof. As. Dr. Gjergj Sinani is a Professor of Philosophy at University of Tirana, Faculty of Social Sciences, Department of Philosophy and Sociology, Tirana – ALBANIA  
His research fields of interest are Philosophy of History, Philosophy of Religion, Sociology of Religion and Phenomenology  
Tel, Fax: 355 4 2303 69; E-mail: gjsinani@yahoo.com

## PROJEKTET PËR EUROPËN NË SHEK. XVIII

Origjinën e shumë projekteve për Europën duhet ta kërkojmë në kozmopolitizmin e intelektualëve europianë. Volteri, Rusoi, d'Alamberi, Monteskjë dhe autorë të tjerë të Enciklopedisë janë përfaqsesit më të shquar të këtij kozmopolitizmi.

Kozmopolitizmi i Volterit ishte hapatzi european, sepse, për të, popujt e Europës kanë parime të humanizmit që nuk gjenden në pjesët e tjera të botës, ata janë shumë të lidhur ndërmjet tyre, ata kanë ligje që janë të përbashkëta, të gjitha shtëpitë e sovranëve janë aleate, subjektet e tyre udhëtojnë vazhdimisht dhe kanë lidhje reciproke. “Europeanët e krishterë janë siç ishin grekët; ata bëjnë luftë ndërmjet tyre, por në këto grindje ata ruajnë aq korrektësi... sa shpesh një francez, një anglez, një gjerman që takohen duken se kanë lindur në të njejtin qytet”. Ndoshta Volteri nuk do t'i kishte shkruar këto rreshta sikur të shikonte dy luftërat e fundit. Rusoi në “Qeverisja e Polonisë” do të shkruante: “Sot nuk ka më francezë, gjermanë, spanjollë, as anglezë; ka vetëm europianë. Të gjithë kanë të njejtat shije, të njejtat pasione, të njejtat zakone, sepse asnjë nuk ka marrë formë nacionale përmes një institucioni të veçantë”. Mirëpo, ndërsa Volteri, në tekstin e bukur që sapo cituam, është i kënaqur me këtë europianizim, Rusoi, si gjithmonë i hidhur në vërejtjet e tij, e përbuz këtë europianizim. Rusoi në veprën *Qeveria e Polonisë* do të shkruante: “Sot nuk ka më francezë, gjermanë, spanjollë, as anglezë; ka vetëm europianë. Të gjithë kanë të njejtat shije, të njejtat pasione, të njejtat zakone, sepse asnjë nuk ka marrë formë nacionale përmes një institucioni të veçantë. Të gjithë, nën të njejtat rrethana, do të bëjnë të njejtat gjëra; të gjithë do të shtiren të ç'interesuar dhe do të jenë shejtanë; të gjithë do të flasin për të mirën publike dhe do të mendojnë vetëm për veten e tyre; të gjithë do të lëvdojnë mediokritetin dhe do të duan të jenë Crésus; ata do të kenë ambicion vetëm lluksin, ata do të kenë pasion vetëm për arin: të sigurtë se kanë me të gjithçka që i grish, të gjithë i shiten të parit që do të donte t'i blente. Ç'rëndësi ka për ta se kujt zotërie i binden, ligjet e kujt shteti ndjekin? Mjafton që ata të gjejnë para për të vjedhur dhe gra për t'i korruptuar, ata janë kudo në vendin e tyre”<sup>1</sup>.

Edhe Monteskjë ishte një kozmopolit. Ai refuzonte t'i propozonte princit të tij diçka të dobishme për kombin e tij, por shkatërrues për një tjetër. “Unë jam një qenie njerëzore para se të jem një francez”, thoshte ai. Një gjë e dobishme për atdheun, por shkatërruese për të tjerët do të ishte një krim; një gjë e dobishme për Europën, por paragjykuese për njerëzimin do të ishte, po ashtu, një krim. Po kështu Didëroi fliste për “koka të vogla, shpirtëra të keqlindur, indiferentë ndaj fatit të njerëzimit dhe aq të përqëndruar në shoqëritë e tyre të vogla – kombin e tyre – sa ata nuk shikojnë asgjë përtej interesit të vet. Këta njerëz duan që t'i quajnë qytetarë të mirë, dhe unë e pranoj, veçse ata të më lejojnë që t'i quaj njerëz të ligj”.

Kështu, për filozofët e shek. XVIII ishte krejt e natyrshme të flitej për njerëzit dhe pastaj për europianët. “Europa jonë” shkruante Volteri te “Ese mbi zakonet”, megjithëse përkatësia ndaj një

---

<sup>1</sup> J.J. Rousseau, *Du Contrat social et autres oeuvre politiques*, Editions Garnier, 1975, f. 347.

“atdheu”, ndaj një “kombi” e vështiros. Sigurisht, kjo temë është shumë komplekse, pasi dhe koha kur shkruheshin këto gjëra ishte shumë komplekse.

Për Rusoin, për shembull, “nacionalizmi” i tij, me disa rezerva përsa i përket përmasës së kombit, është më i fortë se kozmopolitizmi. Kozmopolitizmi është më i gjallë te Volteri. Në vende të tjera, si Anglia, kozmopolitizmi u transformua në patriotizëm.

Ideja e paqes, duke qenë qëndrore në mendimin filozofik, shpuri në projekte ku vihet re një lidhje ndërmjet kozmopolitizmit europian dhe një forme të caktuar utopish. Shumë prej tyre kanë reminishenca europiane. Le të ndalemi në disa prej këtyre projekteve.

Në 1693, Ëilliam Penn, shkroi *Essay toëards the present and future of Europe*. Sistemi që ai parashikonte konsistonte në një marrëveshje të princvave sovranë për thirrjen e një asambleje: “Dietë sovrane ose imperiale, Parlament ose Shtet i Europës”. Kjo asamble do të mblidhej një herë në vit dhe do të formulonte rregullat, me të cilat princat duhej të konformoheshin. Ajo do të arbitronte zënkat ndërmjet tyre dhe ky arbitrazh do të ishte i detyrueshëm, ose çdo refuzim arbitrar nga një fuqi do të kishte si pasojë ndërhyrjen e armatosur të të gjithë të tjerëve. Numri i të deleguarve të princave në asamble do të ishte 12 për Perandorinë, 10 për Francën dhe Spanjën, 8 për Italinë, 6 për Anglinë, 4 për Suedinë, Poloninë, Vendet e Ulëta, 3 për Portugalinë, Danimarkën, Venecien, 2 për 13 kantonet e Zvicrës, 1 për dukatin e Holshtainit dhe të Kurlandit. Gjithashtu, në këtë asamble mund të pranoheshin Perandoria Otomane dhe Moskovia (kështu quhej atëherë Rusia), secila me 10 delegatë. Gjuhët zyrtare do të ishin frëngjishtja dhe latinishtja.

Me përjashtim të rasteve të konflikteve, princat do të ruanin sovranitetin e plotë. Mund të ndërmerrej edhe çarmatimi për të bërë të mundur zhvillimin e bujqësisë, tregëtisë, shkencës dhe arsimit. Reputacioni i krishtërimin do të ruhej, i cili do të mundësonte bashkimin kundër rrezikut turk.

Një dishepull tjetër i Penn, John Bellers, do t’i propozonte parlamentit britanik një projekt me titull: *Some Reasons for an European State, 1710, Proposed to the Poëers of Europe by an Universal Guarantee and an Annual Congress, Senate, Diet or Parliament. To Settle Any Disputes about the Bounds and Rights of the Princes...* Në dallim nga Penn, ai mendonte se ky system, në radhë të parë, duhej të drejtohej kundër Francës, që atëherë ishte pothuaj në luftë kundër tërë Europës. Në momentin që do të arrihej paqja, atëherë Franca mund të pranohet. *Statu quo* që do të krijohet në të ardhmen nga traktati nuk do të mund të ndryshohej më dhe të gjithë anëtarët, në mënyrë solemne, do të hiqnin dorë nga pretendimet e tyre. Europa do të ndahej në pesë province dhe secila do ta furnizonte Lidhjen ose me 1000 ushtarë, ose anije, ose të holla. Shtetet do të ekzistonin. Ai parashikonte aq përfaqësues në Dietë sa ç’ishin provincat. Procedura e arbitrazhit të detyrueshëm do të ishte si ajo e Penn.

Këto projekte nuk patën ndonjë jehonë të madhe. Nuk do të ndodhte kështu me tri volume të mëdha të botuara nga sekretari i kardinalit Polinjak, një nga përfaqësuesit francezë në Konferencën e paqes së Utrehtit. Ky ishte abati Charles-Irénée Castel de Saint-Pierre, në

periudhën 1713 dhe 1717. Që në 1712, në Këln, ai kishte shkruar një vepër të vogël me titull *Mémoires pour rendre la paix perpetuelle en Europe*. Vëllimi i dytë titullohej: *Projet pour rendre la paix perpetuelle en Europe*, dhe e treta: *Projet pour rendre la paix pepetuelle entre souverains chrétiens*. Vihet re dilema ndërmjet idesë së Europës dhe asaj të krishtërimit.

Abati Saint-Pierre mendonte se duhej krijuar një Konfederatë vetëm për Europën. Vetëm një konfederatë e tillë do të siguronte një paqe që ekuilibri i forcave ndërmjet Francës dhe Austrisë nuk mundi ta mbante. Sovranët do të krijonin një “Shoqatë europiane” dhe do të dërgonin aty përfaqësues të përhershëm në një Kongres ose Senat të përhershëm. Shoqata do të ndalonte çdo dhunë. Në qoftë se ndonjë nga sovranët do të ndërmerre një dhunë, atëherë Shoqata do të dërgonte një komision hetimor, por edhe trupa. Sovranët angazhoheshin se do të ruanin *statu – quonë* dhe nuk mund të procedonin me shkëmbime territore, as të firmosnin traktate pa aprovimin e Kongresit me një mazhorancë prej  $\frac{3}{4}$ . Për të penguar një fuqi që të bëhej shumë e madhe, asnjë sovran, përveç perandorit, nuk mund të zotëronte më shumë se një shtet. Problemet në lidhje me tregëtinë do të rregulloheshin nga “Dhoma për ruajtjen e tregëtisë”, të krijuara në qytete të ndryshme. Abati parashikonte që shoqata të përbëhej nga 24 anëtarë europianë, por mund të formohej sapo 14 princa pranonin të aderonin. Që nga ky çast çdo princ që do të refuzonte që të futej aty do të konsiderohej si “armik i Europës”. Anëtarët do t’i bënin luftë dhe në rast se ai ngulmonte, atëherë ai do të largohej nga shteti. Çdo luftë, përveç këtyre sanksioneve ushtarake kolektive, do të ndalohej dhe do ta ekspozonte autorin e saj ndaj sanksioneve të përmendura.

Në dallim nga projekti i Penn që e shikonte numrin e të deleguarve në varësi të pasurisë së shteteve, abati propozonte që secili nga 24 anëtarët të kishte vetëm një delegat. Përkundrazi, kontributet financiare do të ishin proporcionale me të ardhurat e shteteve. E gjitha kjo, që përbente “nenet themelore”, mund të amendohej vetëm në unanimitet. Nenet e tjera, të quajtura “nene të rëndësishme” dhe “nene të dobishme” kërkonin një mazhorancë prej  $\frac{3}{4}$ .

“Nenet e rëndësishme” propozonin që vendi i Kongresit të ishte Utrehti, që Shoqata të kishte një ambasadur në çdo vend anëtar dhe një “resident” në çdo provincë të madhe. Shoqata kishte për detyrë që të studjonte edhe rivalitetet koloniale me qëllim që të mos ishin shkaqe luftime.

Që ky plan ishte utopik e tregon një letër që filozofi gjerman Leibnic i dërgonte autorit më 1715. Shprehja “paqe e përhershme” i dukej jo realiste. Për më tepër, si mund të imagjinohej që princat të bindeshin që të braktisnin një pjesë thelbësore të sovranitetit të tyre si dhe tërë ambicjet e tyre, me leximin e vetëm të një libri? Këtë iluzion të mirë mjafton që ta krahasojmë me atë që shkruante Frederiku II në testamentin e tij më 1768. “Nuk ka asnjë princ të madh që nuk lidhet me idenë për të zgjeruar fuqinë e vet”. Megjithatë, në qoftë se ndikimi i abatit për momentin ishte i natyrës thjesht intelektuale, në të ardhmen ai frymëzoi shumë burra shteti si Necker, Napoleoni, Meternihu dhe, më vonë, burrat e Lidhjes së Kombeve, të cilët i rimorën disa nga këto ide si, sanksionet e detyrueshme, ç’armatimi i kontrolluar, shoqata e shteteve sovraane dhe jo e popujve etj., interesi për tregëtinë, e cila duhej të rregullohej nga Senati, ndoshta ka ndikuar në

krijimin e “Komisionit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara”. Po kështu, ai ishte kundër traktateve secrete, pasi Shoqata duhej të aprovonte – dhe jo vetëm të regjistronte – të gjitha traktatet e nënshkruara nga anëtarët. Dy shekuj më pas do të ishte Eïllsoni që do të kërkonte mosnjohjen e traktateve të fshehta në rregullimin e paqes ndërkombëtare.

Rusoi do të interesohej shumë për këtë projekt. Plani i tij ngjan me atë të abatit. Nga njera anë ai botoi një shkrim të shkurtër më 1761 me titullin: *Extrait du projet de paix pepetuelle de M. l'abbé de Saint-Pierre*. Nga ana tjetër, ai do t'i shtojë veprën *Jugement sur la paix pepetuelle* që u botua më 1782, katër vjet pas vdekjes së tij. Plani i Rusoit ngjan me atë të abatit në kuptimin se filozofi i Gjenevës mendonte, si paraardhësi, se lufta duke qenë çështje e princave, atëherë vetëm përmes një federate princash ajo mund të shmangej. Ai adoptoi të njejtën teknikë të strukturës permanente me 19 anëtarë në vend të 24 si abati, duke përfshirë këtu edhe Rusinë dhe papën. Ashtu si abati ai mbështetej në idenë e efikasitetit të sanksioneve ushtarake.

Dallimi ndërmjet tyre qëndron në stilin e të shkruarit. Në dallim nga vepra e abatit që ishte voluminoze dhe e rëndë, vepra e Rusoit karakterizohej nga një logjikë e mprehtë, qartësia dhe rregullsia. Por, te Rusoi dallohej edhe një pikë tjetër e fortë. Ndërsa abati e bazonte projektin e tij në dëshirën e princave për të ndjekur të mirën e subjekteve të tyre, Rusoi, që nuk i donte princat, mendonte se ata do të aderonin në një plan të tillë vetëm në qoftë se ai do të përputhej me interesat e tyre. Thelbësor në arsyetimin e tij ishte se gjithçka do të ecte mirë në qoftë se princat do të zëvendësoheshin nga shtete të ngritura mbi parimin e vullnetit kombëtar.

Ndërmjet viteve 1786 dhe 1789, Jeremy Bentham shkroi esenë, që u botua më 1843, *A Plan for Universal and Perpetual Peace*. Fjala “universal” do të thoshte se çdo shkaktar i luftës do të shpallej i padenjë nga Europa. E rëndësishme në esenë e tij ishte se ai parashikonte krijimin e një “Gjykate botërore”, vendimet e të cilës do të botoheshin nga shtypi i bërë i lirë dhe kështu do të gëzonte mbështetjen e opinionit publik. Utopia këtu nuk konsistonte në krijimin e një makine të rëndë që do të kufizonte sovranitetin e princave sovranë, por në besimin se opinionit publik do të kishte forcën që të respektoheshin vendimet e gjykatës dhe të imponohje ç'armatimi. Meqë, për më tepër, Bentham shtronte si kusht fillestar që kombet të hiqnin dorë nga kolonitë, projekti kishte shumë pak shanse që të pranohej.

Plani i madh i këtij shekulli ishte ai i Emmanuel Kant-it i botuar më 1795 në Këningsberg në titullin: *Historia universale nga një pikëpamje kozmopolite*. Kanti u frymëzua nga traktati i Bazelit më 1795, ashtu si Saint-Pierre nga traktati i Utrehtit më 1713. Edhe ky projekt bën pjesë në vargun e prjekteve utopiste të shek. XVIII. Ashtu si paraardhësit, ai propozoi krijimin e një konfederate të përgjithshme të shteteve europiane. Për më tepër, ashtu si ata, ai ishte kundër traktateve secrete, ndaj ushtrive permanente, ndaj përdorimit të forcës për avantazhe kombëtare. Nën ndikimin e nacionalizmit që ishte në zhvillim, ai shtoi idenë se asnjë shtet i pavarur nuk mund t'i nënshtrrohej një tjetri. Le të kujtojmë me këtë rast se ndarja e tretë e Polonisë u bë pikërisht më 1785.

Sistemi i Kantit bazohej në idenë e re se për të siguruar paqen e përhershme, regjimet e shteteve duhej të ishin republikane. Në një republikë, pëlqimi i qytetarëve ishte i domosdoshëm për të ndërmarrë një luftë. Kanti dallonte republikën, ku pushteti ekzekutiv është i ndarë nga ai legjislativ, nga “demokracia” ku kjo ndarje nuk ekziston dhe që atëherë i korespondonte “despotizmit”. Në këtë ndarje ai kishte parasysh përvojën franceze të revolucionit me terrorin jakobin.

Megjithëse shumë më i mjegullt se projektet e mëparshme, përsa i takon mekanizmit të konfederatës, projekti i Kantit është më pak utopik. Kushtet e vendosura për realizimin e konfederatës tregonin se kjo ende nuk ishte gati që të lindëte. Le të ndalemi më nga afër me idenë e Kantit, e cila do të frymëzonte edhe presidentin Ëilson mbas Luftës I Botërore, me idenë e tij për Lidhjen e Kombeve.

Në pohimin e shtatë Kanti na thotë se “Problemi i vendosjes së një forme civile të përkryer është i lidhur me problemin e vendosjes së marrëdhënieve të rregullta ndërmjet shteteve, dhe nuk mund të zgjidhet pavarësisht nga kjo e fundit”<sup>2</sup>. Sipas Kantit, ashtu si individët janë të detyruar të bashkohen, por zotërojnë një liri individuale, po kështu çdo bashkësi, në marrëdhëniet me jashtë, domethënë në marrëdhënie me shtete të tjera, gëzon një liri pa shtrëngesa. Prandaj, çdo shtet duhet të presë që të pësojë nga ana e shteteve të tjera të njejtat të këqia që rëndojnë mbi njerëzit dhe që i detyrojnë që të hyjnë në një shtet civil të drejtuar nga ligje. Edhe njëherë, na thotë Kanti, natyra ka përdorur papërputhshmërinë e njerëzve dhe papërputhshmërinë ndërmjet shoqërive të mëdha dhe trupave politikë si një mjet për të krijuar brenda anttagonizmave të pashmangshme të tyre një gjendje qetësie dhe sigurie. Kështu, përmes luftërash, mjerimit që del prej tyre për shtetet, madje edhe në kohë paqeje, natyra, në përpjekjet e saj, në fillim të papërsosura, pastaj, pas shumë rrënimesh, përmbytjesh, pas shterjes radikale të forcave të tyre të brendshme, i shtyn shtetet që të bëjnë atë që do t’u mësonte arsyeja që të bëjnë, pa u kushtuar prova të trishtuara, “domethënë të dalin nga gjendja arkaike e egërsisë për të hyrë në *Shoqatën e Kombeve*. Aty, secili, përfshirë dhe shtetin më të vogël do të mund të arrijë garancinë e sigurisë dhe të drejtave të tij, jo vetëm të fuqisë së vet ose vlerësimin e vet për të drejtat e tij, por vetëm e vetëm të kësaj *Shoqate të Kombeve*, domethënë të një force të bashkuar dhe të një vendimi të marrë sipas ligjesh të bazuara mbi marrëveshjen e vullneteve”<sup>3</sup>. Kjo është e vetmja rugëdalje me qëllim që njerëzit të dalin nga mjerimi ku duan të zhysin njeri tjetrin dhe duhet t’i detyrojnë shtetet që të pranojnë zgjidhjen që të heqin dorë nga liria brutale për të kërkuar qetësi dhe siguri në një formë në përputhje me ligjet. “Kështu, një ditë, pjesërisht, përmes vendosjes së një kushtetute civile sa më adeguate në planin e brendshëm, pjesërisht, në planin e jashtëm, përmes një konvente dhe legjislacioni të përbashkët, do të vendoset një gjendje e gjërave që, si një bashkësi civile universale, do të mund të konsiderohet nga vetvetja si një automat”<sup>4</sup>.

---

<sup>2</sup> E. Kant: *Opuscles sur l’histoire*, Flammarion, Paris, 1990, f. 79.

<sup>3</sup> Po aty: f. 79 - 80.

<sup>4</sup> Po ty: f. 80.

Shkurt, për të shpëtuar nga luftërat ku të shpie “liria barbare e shteteve” duhet krijuar një organizëm racional që ka në bazë parimin e barazisë për veprimet dhe reaksionet reciproke, me qëllim që të mos shkatërrojnë njeri tjetrin. “Megjithëse ky organizëm politik për momentin është ende një skicë shumë e përgjithshme, një ndjeshmëri po shihet te të gjithë anëtarët; rëndësi ka ruajtja e kolektivitetit. Ajo që jep shpresë, pas shumë revolucionesh dhe ndryshimesh, tek e fundit, qëllimi më i lartë i natyrës, është një *Shtet kozmopolit universal që një ditë do të arrijë që të vendoset*; vatra ku do të zhvillohen të gjitha prirjet fillestare të llojit njerëzor”<sup>5</sup>.

## EUROPA PAS LUFTËS II BOTËRORE

Këto ide do të rishfaqen mbas Luftës II Botërore, kur filloi procesi i rimodelimit të Europës. Që ky rimodelim të ishte i suksesshëm duhej që idetë të inkorporoheshin në bashkësitë njerëzore. Krijimet e mëdha dalin nga idetë e mëdha. Sjellja e këtyre ideve është e domosdoshme për të kuptuar se çfarë ndodhi në Europë pas vitit 1945. Këtu duhet të mbajmë parasysh tri elemente; rolin e rrethanave, ekzistencën e krijuesve, prirjet mbështetëse në bashkësitë njerëzore.

Rrethanet e 1945 janë të njohura. Europa jo vetëm që ishte e shkatërruar nga lufta, por edhe moralisht ishte prekur rëndë. Nga ana tjetër, përparimi i ushtrisë së kuqe shpuri në krijimin e dy sektorëve të ndarë përmes një “perde të hekur”. Për perëndimin ishte prezencë e një kërcënimi, sigurisht për shumicën, sepse kishte komunistë dhe simpatizantë që dëshironin, në mos një përparim të ushtrisë së kuqe, të paktën revolucione për të vendosur regjime analoge me atë të BRSS. Për një kohë të gjatë situata mbeti e pasigurtë, të paktën për Francën, Italinë dhe Greqinë, për shkak edhe të prestigjit dhe heroizmit të komunistëve në këto vende.

Kërcënimi, për shumicën e popullsisë perëndimore, përputhej me rrezikun e vendosjes së regjimeve të tipit stalinist, ku liria individuale sakrifikohesh në favor të triumfit të proletariatit, sipas normave të vendosura nga pararoja e tij, partia komuniste.

Nga rrënojat dhe kërcënimi shfaqet, në mënyrë indirekte, një rrethanë tjetër, që ishte dalja e një politike krejt të re të SHBA. Ky vend doli nga izolacionizmi tradicional duke hyrë në Luftën e madhe dhe doli si një nga dy “të mëdhenjtë”. Dilema ishte; do të rikthehej në qëndrimin e mëparshëm për tu mbyllur në “fortesën amerikane”? Mirëpo, pas Jaltës, aleanca me “të madhin” tjetër u prish duke shkuar drejt luftës së ftohtë. Çfarë duhej bërë? A duhej të vazhdohej aleanca duke i bërë koncesione BRSS, për ta ruajtur këtë aleancë? Apo i duhej kundërvënë këtij aleati dhe për ta frenuar? Emërimi i gjeneralit Marshall në departamentin e shtetit më 1947 shënoi fitoren e prirjes së dytë. Dihet që pas lufte prirja është kthimi në normalitet (*back to normalcy*), domethënë kthimi te buka, paqja dhe liria. Këtij qëllimi i shërbeu plani Marshall. Rrethanë tjetër ishte rënia e ethes nacionaliste. Madje Franca që në kushtetutën e 1946 futi parimin e braktisjes së disa pjesëve të sovranitetit kombëtar, në favor të reciprocitetit. Kështu, nacionalizmi shoven u thye në Europë. Kjo u pa edhe në lëvizjet intelektuale në Europë. Mjafton të përmendim shkurtimisht shoqatat e ndryshme europiane që formuan si “Uninionin europian të federalistëve”.

---

<sup>5</sup> Po aty: f. 86.

Kjo lëvizje u zhvillua te konservatorët (Çurçilli), te kristian demokratët (Ekipet e reja ndërkombëtare), te socialistët (Lëvizja socialiste për Shtetet e Bashkuara të Europës). Mori edhe forma politike dhe ekonomike (Lidhja europiane e kooperimit ekonomik. Në 1947, konti Kudenhovë-Kalerxhi zhvilloi inisiativën pranë parlamenteve për të krijuar “Unionin parlamentar europian”. Në rrafshin intelektual, që më 1947, u krijuar “Komiteti ndërkombëtar i kooperimit të Lëvizjeve për Universitetin europian”. Në 1948, në Hagë u mbledh një kongres spektakolar ku morën pjesë shumë ministra në detyrë. Prej këtej lindi ideja e bashkimit të të gjitha grupeve në një “Lëvizje europiane”, e themeluar në tetor 1948 ku presidentë qenë Çurçilli, Leon Blumi, Pol-Henri Spik, Alçide de Gasperi. U krijuan edhe institute europiane në Bryzh, Torino, Sarrebruk, Nansi dhe shumë qendra të tjera. Ideja dhe rrethanat kërkonin individët.

Inisiativa u mor në korrik 1948 nga Zhorzh Bido. I impresionuar nga Kongresi i Hagës, ai propozoi thirrjen e një asambleje europiane të zgjedhur. Ky projek u rimor me forcë nga Robert Shuman, që e zëvendësoi në postin e ministrit të jashtëm. Kjo inisiativë u prit mirë nga Belgjika, Vendet e Ulëta dhe Luksemburgu që e pranuan idenë e një asambleje që do të kishte disa pushtete mbikombëtare. Britania, nën qeverisjen travajiste që i jepte rëndësi Komonuelthit, paraqiti një kundër projekt që nuk e pranonte mbinacionalitetin dhe propozoi krijimin e një Komitetit ministrash. Kur negociatat morën fund më 1949, “Këshilli i Europës” dukej se ishte një kompromis ndërmjet tezës franceze dhe tezës britanike, pasi përbëhej nga një Asamble konsultative dhe një Komitet ministrash. Në fakt kjo ishte në dukje. Në thelb fitoi teza britanike, sepse nuk u pranua një pushtet mbinacional. Ndryshimi nga qëndrimi para luftës ishte se ata pranuan ekzistencën e një organizmi specifik europian. Në përgjithësi ata zbatonin në praktikë politikën *back to normalcy*.

Pikërisht, në sajë të këtij qëndrimi britanik, Këshilli i Europës kishte një rol të reduktuar, terren takimi dhe kooperimi. Kjo nuk i kënaqte partizanët e Europës. Një gërshetim i ri rrethanash kërkonin rishikimin e çështjes. Rrethana kryesore ishte dalja e Gjermanisë si subjekt – jo më si objekt – i diplomacisë, me krijimin e RFGJ më 1949. Për aq kohë sa do të kishte shtet gjerman për aq kohë do të kishte edhe rivendikime kundrejt territoreve gjermane të ndara. Me e rëndësishme ishte zona sovjetike dhe territoret e aneksuara Polonisë. Por, më e prekshme ishte Sarra, që Franca ia kishte shkëputur politikisht Gjermanisë dhe ja kishte bashkuar zonës së saj ekonomike. Robert Shuman donte një pajtim franko – gjerman. Si mund të kapërxehej problemi i Sarrës në mënyrë që të mos krijonte konflikt ndërmjet Francës dhe Gjermanisë? A mund të lidhej kjo me problemin e bashkimit europian?

Zgjidhja u gjet nga Zhan Mone, që ishte ideja e integritetit. Shumë kohë më parë, Shumani propozoi, më 1950, planin që mban emrin e tij duke hedhur një hap të madh përpara. Plani Shuman parashikonte krijimin e një “Komuniteti europian të qymyrit dhe çelikut”, bazuar mbi një treg të përbashkët, objektiva dhe institucione të përbashkëta. Le të marrim dy fraza nga hyrja e traktatit. “Duke marrë parasysh se paqja botërore mund të ruhet vetëm përmes përpjekjesh krijuese në masën e rreziqeve që e kërcënojnë”. Më pas: “Duke marrë parasysh se Europa mund

të ndërtohet vetëm përmes realitetesh konkrete, duke krijuar së pari, një solidaritet faktik dhe përmes krijimit të bazave të përbashkëta të zhvillimit ekonomik”.

Ajo që ishte revolucionare në idenë e integritit, ishte sinteza ndërmjet dy ideve të thjeshta; mbinacionalitetit dhe realitetet ekonomike konkrete. Kjo sintezë tregonte se Europa mund të bashkohej, së pari, vetëm në qoftë se ekonomitë e anëtarëve të ndryshëm bashkoheshin, në mënyrë të tillë që të krijohej një unitet real, para se të shpallej një unitet mbi bazën e të drejtës. Kjo ide provokonte edhe një prirje të parëzistueshme drejt unitetit politik.

Zhan Mone e kishte kuptuar rëndësinë e kësaj sinteze edhe për faktin e përvojës së tij politike. Ai kishte drejtuar misionin frnako – britanik të furnizimeve në periudhën 1939 – 1940. Ai kishte qenë një nga inisiatorët e një projekti të bashkimit franko – britanik në qershor 1940. Më 1941, në SHBA, ai kishte vënë në jetë planin “Victory Program”, një plan për fabrikime ushtarake. Më 1943 ai kishte kontribuar në afrimin e dy Francave, atë të De Golit dhe atë të Zhirosë. Ai u bë Komisar i lartë i planit të Republikës së këtrt. Planifikimi, pajtimi, sinteza, domethënë kombinimi ndërmjet qartësisë së idesë dhe imagjinatës, janë tiparet e personalitetit të tij. Shumë autorë mendojnë se pa Zhan Monenë nuk mund të mendohet Europa e sotme. Sidoqoftë, asnjë nuk ishte më i përgatitur intelektualisht dhe i sprovuar praktikisht për të bërë zbulimin e thjeshtë në dukje, por jashtzakonisht frytdhënës në realitet, të idesë së integritit.

Krijimi i “Komunitetit të qymyrit dhe çelikut” hapi një perspektivë të re. Integrimi u tentua edhe për forcat ushtarake (Komuniteti europian i mbrojtjes), por pa sukses. Me sukses ishin përdorimi paqësor i energjisë atomike (Euratom) dhe Tregu i përbashkët europian.

Tashmë Këshilli i Europës, Bashkimi europian, lindën nga e njejta ide, nga e njejta frymë dhe nga i njejti ambicion. Në themel ka ato projekte kozmopolite dhe rrethanat që u krijuan pas Luftës II Botërore. Të gjithë bashkohen në pikën e formuluar shumë bukur nga Riçard Kodonhovë-Kalërxi: “Një Europë e ndarë shpie në luftë, në shtypje, në mjerim; një Europë e bashkuar në paqe, në prosperitet”. Projekti europian eci duke fituar besimin e qytetarëve të saj. Demokracia, shteti i së drejtës, përbëjnë krenarinë e kontinentit. Përhapja e parimeve demokratike, e të drejtave të njeriut dhe e përparësisë së të drejtës mbeten një detyrë e papërfunduar, për faktin se mendimtarët e Europës kanë theksuar që të ruhen nga iluzione se demokracia, me tu vendosur, është e palëkundshme. Demokracia nuk duhet të shndërrohet në një ritual bosh. Prirja e klasave politike dhe strukturave etatike për t’u larguar nga qytetarët përbën një rrezik të përherëshëm për demokracinë. Demokracia është si një organizëm i gjallë. Në qoftë se vendoset mbi një bazament të fortë, ajo ka nevojë që të përshtatet parreshtur, me qëllim që t’i përgjigjet sa më mirë kërkesave të qytetarëve.

Në qoftë se në fillim të refleksionit tonë u nisëm nga projektet që u përpunuan në shek.XVIII dhe më pas bëmë një kapërxim pas Luftës II Botërore, ne lamë pas shumë periudha të rëndësishme të përpunimit të idesë së Europës. Qëllimi ishte që të tregojmë se Europa e sotme është produkt i një përpjekje të gjatë të mendimit dhe aksionit konkret politik praktik. Për më tepër duhen

shmangur keqkuptimet ose përfytyrimet simpliste në lidhje me Europën. Ajo nuk është një sirtar me para, as edhe thjesht një zonë e qarkullimit të lirë për mallrat dhe njerëzit. Europa, në radhë të parë është një hapësirë e lirisë qytetare, solidaritetit dhe përgjegjësisë.

Në themel të mendimit dhe veprimit praktik për Europën qëndron, siç e pamë, ideja e paqes dhe sigurisë. Prej kësaj burojnë rregullimet e lirisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës, si ide që përbëjnë krenarinë e Europës.